



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
REKTORI

Nr. Prot 3269

Shkodër, me 01.10.2019

Lënda: Marrëveshje bashkëpunimi për përfshirjen dhe regjistrimin në Platformën e ofruar në kuadër të projektit GRADUA

Drejtuar: Znj. **Aurora Hoxha**, koordinatorë e projektit 585961-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP (2017 -2926/001 -001) "Graduates Advancement and Development of University capacities in Albania" GRADUA"

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", i njohur gjithashtu edhe si UNISHK, themeluar në vitin 1957, me qendër në Sheshi 2 Prilli, Shkodër, përfaqësuar nga Doc. Julian Kraja (më poshtë Universiteti), pranon të regjistrohet në platformën e projektit GRADUA duke krijuar një bazë së të dhënave për të diplomuarit.

Duke qenë pjesë e platformës, universiteti përfiton nga mjetet inovative të vlerësimit për të adresuar cilësinë e arsimit dhe kështu do të përpiqet të lehtësojë depërtimin e të rinjve në tregun e punës.

Universiteti do të sigurojë një numër minimal të burimeve njerëzore të cilët do të jenë të dedikuar plotësisht për platformën dhe do të angazhohet në:

- Implementimin e aktiviteteve të shpërndara sipas rrjetëzimit të kompanive dhe interesave të studentëve, në mënyrë që të përmirësohet shkalla e regjistrimit dhe cilësia e të dhënave të pyetësorit;
- Mbledhjen e të dhënave për të diplomuarit (të dhëna administrative dhe të dhëna të mbledhura nga pyetësorët) për të plotësuar bazën e të dhënave të platformës së projektit Gradua.
- Pjesëmarrjen në planifikimin e veprimtarive kërkimore dhe hartimin e sondazhit;
- Garantimin e Sigurimit të cilësisë duke transmetuar të dhëna të sakta dhe në përputhje me kriteret e cilësisë të përcaktuara nga Konsorciumi.

Anëtarësimi në Konsorcium, nëpërmjet regjistrimit në platformë nga universitetit realizohet nëpërmjet firmosjes së kësaj marrëveshje dhe nuk ka asnjë kosto financiare.

Rektor

Prof. Dr. Adem BEKTESHI